

UDHËZIM
Nr. 42, datë 15.10.2014

**PËR ARSIMIMIN E INDIVIDËVE TË MOSHËS SHKOLLORE NË INSTITUCIONET
E PARABURGIMIT, TË VUAJTJES SË DËNIMIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 18 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Realizimin e arsimit të individëve të moshës shkollore, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme në institucionet e paraburgimit/të vuarjes së dënimit.

2. Procesi mësimor për arsimin bazë në institucionet e paraburgimit/të vuarjes së dënimit të zhvillohet duke grupuar nxënësit në klasa të bashkuara, sipas grupmoshave përkatësisht në grupin e klasave I-III, IV-VI dhe VII-IX.

3. Arsimit në institucionet e paraburgimit/të vuarjes së dënimit të zhvillohet në përputhje me kurrikulën e arsimit publik.

Struktura e vitit mësimor të jetë e njëjtë me shkollat publike.

4. Klasat në institucionet e paraburgimit/të vuarjes së dënimit të varen nga një shkollë pranë njësisë administrative të institucionit.

5. Drejtorja e shkollës, që ka në varësi klasat në institucionet e paraburgimit/të vuarjes së dënimit, të përfshijë të gjithë nxënësit e këtyre klasave në dokumentacionin bazë të shkollës.

Çdo mësues i këtyre klasave të mbajë dokumentacionin përkatës dhe të dhënat përfundimtare të hidhen në amzën e shkollës.

6. Mësuesit, që do të realizojnë procesin mësimor në institucionet e paraburgimit/të vuarjes së dënimit, të sigurohen brenda numrit të mësuesve në organikën e shkollave publike që kanë në varësi klasat në institucionet e paraburgimit/të vuarjes së dënimit.

7. Instituti i Zhvillimit të Arsimit të përgatisë planet mësimore dhe programet lëndore për klasat në institucionet e paraburgimit/të vuarjes së dënimit.

8. Njësitë arsimore vendore (DAR/ZA), të cilat kanë nën juridiksionin e tyre shkolla që trajtojnë arsimimin e individëve të moshës shkollore në institucionet e paraburgimit/të vuarjes së dënimit, të zbatojnë aktet ligjore dhe nënligjore për arsimimin e tyre, si dhe marrëveshjen e bashkëpunimit lidhur më 24.06.2014, ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Drejtësisë “Për arsimimin e individëve në institucionet e paraburgimit/të vuarjes së dënimit në Republikën e Shqipërisë”.

9. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit Parauniversitar, Instituti i Zhvillimit të Arsimit dhe njësitë arsimore vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla